1. Lista treguese e informacionit për aplikimet për licencë, siç referohet në nenin 29 të Direktivës 2013/59/EUROATOM

1. Përgjegjësitë dhe masat organizative për mbrojtje dhe siguri.
2. Kompetencat e stafit, duke përfshirë informacionin dhe trajnimin.
3. Karakteristikat e projektimit të objektit dhe të burimeve të rrezatimit.
4. Ekspozimet e parashikuara profesionale dhe publike në operim normal.
5. Vlerësimi i sigurisë së aktiviteteve dhe objektit në mënyrë që:
 - 5.1 Identifikojnë mënyrat në të cilat mund të ndodhin ekspozime të mundshme ose ekspozime mjekësore aksidentale dhe të paqëllimshme;
 - 5.2. Vlerësoj, sa të jetë e mundur, probabilitetin dhe madhësinë e ekspozimeve të mundshme;
 - 5.3. Vlerëson cilësinë dhe shtrirjen e dispozitave të mbrojtjes dhe sigurisë, duke përfshirë karakteristikat inxhinierike, si dhe procedurat administrative;
 - 5.4. Përcaktimi i kufijve operacionale dhe kushteve të operimit.
6. Procedurat e emergjencës.
7. Mirëmbajtjen testimin, inspektimin dhe servisimin në mënyrë që të sigurohet që burimi i rrezatimit dhe objekti të vazhdojnë të përmbushin kërkesat e projektimit, limitet operacionale dhe kushtet e operimit gjatë gjithë jetës së tyre.
8. Mirëmbajtjen e mbetjeve radioaktive dhe masat për depozitimin e këtyre mbeturinave, në përputhje me kërkesat rregullative në fuqi.
 - 8.1. Menaxhimi i burimeve të papërdorshëm.
 - 8.2. Sigurim i cilësisë.

1.10. Aneksi X

Sistemi i të dhënave për monitorimin individual radiologjik të përmendur në nenin 43, 44 and 51 të Direktivës 2013/59/EUROATOM

DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Sistemi i të dhënave për monitorimin individual radiologjik të krijuar nga Agjencia mund të realizohet ose si një rrjet ose si një regjistër kombëtar i dozave. Ky sistem i të dhënave mund të përfshijë lëshimin e dokumenteve individuale të monitorimit radiologjik për punëtorët e jashtëm.

1. Çdo sistem i të dhënave për monitorimin individual radiologjik të punëtorëve të ekspozuar duhet të përfshijë seksionet si në vijim:

1.1. Të dhënat në lidhje me identitetin e punëtorit;

1.2. Të dhënat në lidhje me mbikëqyrjen mjekësore të punëtorit;

1.3. Të dhënat në lidhje me ndërmarrjen e punëtorit dhe, në rastin e një punonjësi të jashtëm, punëdhënësin e punëtorit;

1.4. Rezultatet e monitorimit individual të punëtorit të ekspozuar.

2. Agjencia ndërmerr masa të nevojshme për të parandaluar ndonjë falsifikim ose keqpërdorim ose manipulim me sistemin e të dhënave për monitorimin individual radiologjik.

A. Të dhënat duhet të përfshihen në sistemin e të dhënave për monitorimin individual radiologjik

3. Mbi identitetin e punonjësit përfshihen këto të dhëna të punëtorit:

3.1. Mbiemri;

3.2. Emri;

3.3. Gjinia;

3.4. Datën e lindjes;

3.5. Kombësia; dhe

3.6. Numrin unik i identifikimit.

4. Të dhënat mbi ndërmarrjen duhet të përfshijnë emrin, adresën dhe numrin unik të identifikimit të ndërmarrjes.

5. Të dhënat mbi punësimin e punëtorit duhet të përfshijnë:

5.1. Emrin, adresën dhe numrin unik të identifikimit të punëdhënësit;

5.2. Datën e fillimit të monitorimit individual; dhe aty ku është e mundur, data e fundit;

5.3. Kategorizimin e punëtorit në përputhje me nenin 40 të Direktivës.

6. Rezultatet e monitorimit individual të punonjësit të ekspozuar përfshijnë të dhënat zyrtare të dozës (vit, dozën efektive në mSv, në rast të ekspozimit jo uniform, dozave ekuivalente në pjesë të ndryshme të trupit në mSv dhe në rastet e konsumit të radionuklideve, dozën e pritshme efektive në mSv);

B. Të dhënat për punëtorët e jashtëm që do të furnizohen nëpërmjet sistemit të të dhënave për monitorimin individual radiologjik

1. Para fillimit të çdo aktiviteti, punëdhënësi i punonjësit të jashtëm I jep të dhënat e mëposhtme ndërmarrjes nëpërmjet sistemit të të dhënave për monitorimin individual radiologjik:

1.1. Të dhënat për punësimin e punëtorit të jashtëm në përputhje me Seksionin A, pika 5 të Direktivës;

1.2. Të dhënat për mbikëqyrjen mjekësore të punëtorit duhet të përfshijnë:

1.2.1. Klasifikimi mjekësor i punëtorit në përputhje me Nenin 46 të Direktivës (i aftë, i aftë në varësi të kushteve të caktuara, i paaftë);

1.2.2. Informacion për çdo kufizim në punën me rrezatim;

1.2.3. Datën e vizitës periodike shëndetësore të fundit; dhe

1.2.4. Periudhën e vlefshmërisë së rezultatit.

1.2.5. Rezultatet e monitorimit individual të ekspozimit të punonjësit të jashtëm në përputhje me Seksionin A, pika 6, dhe së paku për pesë vitet kalendarike të fundit duke përfshirë edhe vitin aktual.

2. Të dhënat e mëposhtme do të regjistrohen ose janë regjistruar nga ndërmarrja në sistemin e të dhënave për monitorimin individual radiologjik pas përfundimit të çdo aktiviteti:

2.1. Periudhën e mbuluar të veprimtarisë;

2.2. Një vlerësim të çdo dozë efektive të marrë nga punëtori i jashtëm (për periudhën e mbuluar të veprimtarisë);

2.3. Në rast të ekspozimit jo uniform, një vlerësim të dozave ekuivalente në pjesët e ndryshme të trupit;

2.4. Në rast të konsumit të radionuklideve, një vlerësim të konsumit ose dozën e

prishme efektive.

C. Dispozitat në lidhje me dokumentin e monitorimit radiologjik individual

1. Agjencia mund të vendos të lëshojnë një dokument monitorimi radiologjik individual për çdo punëtor të jashtëm.
2. Dokumenti nuk është i transferueshëm.
3. Agjencia ndërmerr masat e nevojshme për të parandaluar që një punëtor të lëshohet me më shumë se një dokument monitorimi individual të vlefshëm në të njëjtën kohë.
4. Përveç informacionit të kërkuar në Pjesën A dhe Pjesën B, dokumenti duhet të përfshijë emrin dhe adresën e organit lëshues dhe datën e lëshimit.

1.11. Aneksi XI

Sistemi i menaxhimit të emergjencave dhe planet e reagimit të emergjencave të përmendura në nenet 69, 97 dhe 98 të Direktivës 2013/59/EUROATOM

A. Elementët që do të përfshihen në një sistem të menaxhimit të emergjencave

1. Vlerësim të situatave emergjente të mundshme të ekspozimit dhe ekspozimet publike dhe emergjent shoqëruese në punë;
2. Ndarjen e qartë të përgjegjësive për personat dhe organizatat që kanë rol për marrjen e masave në gatishmëri dhe reagim;
3. Krijimin e planeve të reagimit emergjent në nivele të duhura dhe të lidhura për një objekt të veçantë ose aktivitet njerëzor;
4. Komunikime të besueshme dhe marrjen e masave efikase dhe efektive për bashkëpunim dhe koordinim në instalime dhe në nivele të duhura kombëtare dhe ndërkombëtare;
5. Mbrojtja e shëndetit të punëtorëve të emergjencës;
6. Masat për sigurimin e informacionit dhe trajnimin paraprak për punonjësit e emergjencave dhe të gjithë personave tjerë me detyra ose përgjegjësi në regimin emergjent, duke përfshirë ushtrimet e rregullta;
7. Masat për monitorimin ose vlerësimin individual të dozave individuale të punëtorëve të emergjencës dhe regjistrimin e dozave;
8. Marrja e masave për informimin publik;
9. Përfshirja e palëve të interesuara;
10. Kalimi nga një situatë e ekspozimit emergjent në një situatë ekzistuese ekspozimi, përfshirë rikuperimin dhe rehabilitimin.

B. Elementet që do të përfshihen në planin e reagimit emergjent - Për gatishmëri në raste emergjente

1. Nivelet e referencës për ekspozimin publik, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në Nenin 36 nënparagrafin 1.1;
2. Nivelet e referencës për ekspozimin emergjent në punë duke marrë parasysh Nenin 53 të Direktivës.
3. Strategjitë e optimizuara mbrojtëse për anëtarët e publikut që mund të ekspozohen, për ngjarje të ndryshme të supozuara dhe skenarë të ngjajshëm;
4. Kriteret e paracaktuara shqyrtuese për masa të veçanta mbrojtëse;

5. Shkaqet e parazgjedhura ose kriteret operationale të tilla si vëzhgimet dhe treguesit e kushteve në vendngjarje;

6. Masat për koordinim të shpejtë midis organizatave që kanë rol në gatishmërinë dhe reagimin në rastet emergjente dhe me të gjitha shtetet e tjera që mund të përfshihen ose që mund të preken;

7. Masat për rishikimin e planit të reagimit emergjent dhe përmirësimet për të marrë parasysh ndryshimet ose mësimet e nxjerra nga ushtrimet dhe ngjarjet.

7.1. Masat të përcaktohen paraprakisht për të rishikuar këto elemente, sipas rastit, gjatë një situatë të ekspozimit emergjent, për t'i përshtatur kushtet mbizotëruese pasi ato zhvillohen gjatë gjithë reagimit.

8. Për reagimet në emergjenca:

8.1. Reagimi ndaj situatës së ekspozimit emergjent duhet të ndërmerret nëpërmjet zbatimit në kohë të masave të gatishmërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

8.1.1. Zbatimi i menjëhershëm i masave mbrojtëse, nëse është e mundur, para se të ndodhë ndonjë ekspozim;

8.1.2. Vlerësimi i efektivitetit të strategjive, veprimeve të zbatuara dhe rregullimi i tyre sipas situatës mbizotëruese;

8.1.3. Krahasimi i dozave kundrejt nivelit të referencës në fuqi, duke u përqendruar në ato grupe doza e të cilave tejkalon nivelin e referencës;

8.1.4. Zbatimi i strategjive të mëtejshme të mbrojtjes, sipas nevojës, bazuar në kushtet mbizotëruese dhe në informacionin e disponueshëm.

1.12. Aneksi XII

Informacion për anëtarët e publikut për masat që zbatohen për mbrojtjen e shëndetit dhe hapat që duhet të ndërmerren në rast emergjence siç referohen në nenet 70 dhe 71 të Direktivës 2013/59/EUROATOM

A. Informacioni paraprak për anëtarët e publikut që mund të jenë të kërcënohen nga emergjencat:

1. Faktet bazë rreth radioaktivitetit dhe efektet e saj në njerëz dhe mjedis;
2. Llojet e ndryshme të emergjencës dhe pasojat e tyre për publikun dhe mjedisin;
3. Masat e emergjencës të parashikuara për të alarmuar, mbrojtur dhe ndihmuar publikun në rast emergjence;
4. Informacion i duhur për veprimet që duhet të ndërmerren nga publiku në rast emergjence.

B. Informacioni që do t'u ofrohet pjesëtarëve të publikut të prekur në rastet e emergjencës

1. Në bazë të planit të reagimit emergjent të hartuar më parë, anëtarët e publikut që aktualisht preken në rastin e emergjencës do të marrin në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt:

1.1. Informacionin për llojin e emergjencës që ka ndodhur dhe, aty ku është e mundur, karakteristikat e tij (p.sh. origjina, shkalla dhe zhvillimi i mundshëm);

1.2. Këshilla për mbrojtjen, e cila, në varësi të llojit të emergjencës, mund të:

1.2.1. Të mbulojë si më poshtë: kufizimet në konsumin e disa produkteve ushqimore dhe ujit që mund të kontaminohen, rregulla të thjeshta për higjienën dhe dekontaminimin, rekomandimet për të qëndruar brenda, shpërndarjen dhe përdorimin e substancave mbrojtëse, masat e evakuimit;

1.2.2. Shoqërohet, kur është e nevojshme, me paralajmërime të veçanta për grupe të caktuara të anëtarëve të publikut;

1.3. Paralajmërimet e Agjencisë të cilat rekomandojnë respektimin e udhëzimeve ose kërkesave.

2. Nëse emergjenca paraprihet nga një fazë para-alarmi, anëtarët e publikut që ka gjasa të preken, paraprakisht do të marrin informacione dhe këshilla gjatë asaj faze, siç janë:

2.1. Thirrje anëtarëve të publikut të dëgjojnë kanalet përkatëse të komunikimit;

2.2. Këshilla përgatitore për institucionet me përgjegjësi të veçanta kolektive;

2.3. Rekomandime grupeve profesionale veçanërisht të prekura.

3. Këto informacione dhe këshilla plotësohen, nëse koha e lejon, me një kujtues të fakteve themelore rreth radioaktivitetit dhe efekteve të saj mbi njerëzit dhe mjedisin

1.13. Aneksi XIII

Lista treguese e llojeve të materialeve të ndërtimit të shqyrtuara në lidhje me rrezatimin e tyre të emetuar gama siç referohet në nenin 75 të Direktivës 2013/59/EUROATOM

1. Materialet natyrore

1.1. Alumin argjilor.

1.2. Materiale ndërtimi ose aditivë me origjinë natyrale të zjarra, të tilla si:

1.2.1. Granitoidet (si granitet, syenite dhe ortogjeneze),

1.2.2. Porfirit;

1.2.3. Shtuf;

1.2.4. Pozolana (hiri pozolanik);

1.2.5. Lava.

2. Materialet që përfshijnë mbetjet nga industrinë që përpunojnë materiale radioaktive natyrore, të tilla si:

2.1. Hiri;

2.2. Fosfogipsi;

2.3. Skorje fosforesh;

2.4. Shllak kallaji;

2.5. Shllak bakri;

2.6. Baltë e kuqe (mbetjet nga prodhimi i aluminit);

2.7. Mbetjet nga prodhimi i çelikut

1.14. Aneksi IV

Informacione të cilat duhen dhënë në regjistrat e burimeve të mbyllura me aktivitet të lartë (HASS) nga Neni 89 i Direktivës 2013/59/EUROATOM

LISTA STANDARDE E REGJISTRIT PËR BURIME TË MBYLLKURA ME AKTIVITET TË LARTË (HASS) (opcionale me shkronja italiane)		
1. Numri identifikues i HASS	2. Identifikimi I ndërmarrjes së licencuar	3. Lokacioni i HASS (përdorimi ose magazina) nëse nuk është e njëjtë sikur në pikën 2.
<i>Numri i pajisjes nga prodhuesi</i>	Emërtimi:	Emërtimi:
<i>Fusha e përdorimit:</i>	Adresa:	Adresa:
	Shteti:	Shteti:
	Prodhuesi <input type="checkbox"/>	Përdorim i fiksuar <input type="checkbox"/>
	Furnizuesi <input type="checkbox"/>	Magazinim <input type="checkbox"/>
	Përdoruesi <input type="checkbox"/>	Përdorim mobil <input type="checkbox"/>
4. Regjistrimi i të dhënave	5. Licenca	6. Kontrollat Operative HASS
Data e fillimit të regjistrimit:	Numri:	Data:
Data e kalimit të regjistrat në arkivë:	Data e licencimit:	Data:
	Data e skadimit:	Data:
7. Karakteristikat e HASS	8. Pranimi i HASS	Data:
<i>Viti prodhimit:</i>	Data e pranimit të HASS:	Data:
<i>Radionuklidi:</i>		Data:
Aktiviteti në ditën e prodhimit:	Pranuar nga:	Data:
	Emri:	Data:
	Adresa:	Data:
Data Referente e aktivitetit:	Shteti:	Data:
Prodhuesi/Porositësi (*)	Prodhuesi <input type="checkbox"/>	Data:
Emri:	Furnizuesi <input type="checkbox"/>	Data:
Adresa:	Përdorues tjetër <input type="checkbox"/>	Data:
Shteti:	9. Transferimi i HASS	10. Informacionet tjera
<i>Karakteristikat fizike dhe kimike</i>	Data transferimit:	Humbja <input type="checkbox"/> data humbjes:
<i>Identifikimi I llojit të burimit:</i>	Transferuar tek:	Vjedhja <input type="checkbox"/> data vjedhjes:
<i>Identifikimi I kapsulës:</i>	Emri:	Gjetjet: Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
<i>ISO Klasifikimi:</i>	Adresa:	Data:
<i>ANSI klasifikimi:</i>	Shteti:	Vendi:
<i>LAEA kategorija e burimit:</i>	Numri licencës:	<i>Të dhëna tjera:</i>
	Data licencimit:	
<i>Burim neutronik: Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></i>	Data skadimit:	
<i>Targeti I burimit neutronik:</i>	Prodhuesi <input type="checkbox"/>	
<i>Fluksi neutroneve:</i>	furnizuesi <input type="checkbox"/>	
	Ndërmarrje tjetër <input type="checkbox"/>	
	Objekti për magazinim afatgjatë ose deponim <input type="checkbox"/>	

(*Nëse prodhuesi i burimit është jashtë Komunitetit, mund të vendoset emri dhe adresa e importuesit-furnizuesit

1.15. Aneksi XV

Kërkesat për ndërmarrjet përgjegjëse për një burim të mbyllur me aktivitet të lartë, siç referohet në nenin 91 të Direktivës 2013/59/EUROATOM

1. Çdo ndërmarrje përgjegjëse për një burim të mbyllur me veprimtari të lartë:

1.1. Siguron që testet përkatëse, siç janë testet e rrjedhjes të bazuara në standardet ndërkombëtare, të ndërmerren rregullisht për të kontrolluar dhe mbajtur integritetin e secilit burim;

1.2. Verifikon dhe regjistron çdo javë që çdo burim dhe, aty ku është e rëndësishme, pajisjet që përmbajnë burimin janë ende të pranishme dhe në gjendje të dukshme mirë në vendin e tyre të përdorimit ose magazinimit;

1.3. Të sigurojë që çdo burim fiks dhe i lëvizshëm i nënshtrohet masave adekuate të dokumentuara, siç janë protokollet dhe procedurat e shkruara, që kanë për qëllim parandalimin e qasjes së paautorizuar për humbje ose vjedhje të burimit ose dëmtimin e tij nga zjarri;

1.4. Njofton menjëherë Agjencinë për çdo humbje, vjedhje, rrjedhje ose përdorim të paautorizuar të një burimi, organizon kontrollin mbi integritetin e secilit burim pas çdo ngjarjeje, duke përfshirë zjarrin, që mund të ketë dëmtuar burimin dhe, nëse është e përshtatshme, të njoftojë Agjencinë për masat e marra;

1.5. Të kthejë çdo burim të shfrytëzuar tek furnizuesi ose ta vendosë në një objekt për magazinim ose deponim afatgjatë ose ta transferojë atë në një ndërmarrje tjetër të autorizuar, përveç nëse Agjencia nuk bie dakord ndryshe, pa vonesa të panevojshme pas përfundimit të përdorimit;

1.6. Konstaton se, para se të bëhet transferimi, marrësi ka licencën përkatëse.

1.7. Njoftojë menjëherë Agjencinë për çdo aksident ose incident që rezulton në ekspozimin e paqëllimtë të një punonjësi ose një anëtari të publikut.

1.16. ANEKSI XVI
Identifikimi dhe shënjimi i burimeve të mbyllura me aktivitet të lartë të Direktivës
2013/59/EUROATOM

1. Prodhuesi ose furnizuesi dhe secila ndërmarrje sigurojnë që:

1.1. Çdo burim i mbyllur me aktivitetit të lartë identifikohet me një numër unik. Ky numër duhet të jetë i gdhendur ose vulosur në burim, aty ku është e mundur. Numri gjithashtu do të jetë i gdhendur ose vulosur në enën e burimit. Nëse kjo nuk është e mundur, ose në rastin e transportit me kontejner, kontejneri i burimit, së paku, do të mbajë informacion mbi natyrën e burimit.

1.2. Kontejnerin e burimit dhe, kur është e mundur, burimi shënjohe dhe etiketohet me një shenjë të përshtatshme për t'i paralajmëruar njerëzit për rrezikun e rrezatimit.

2. Prodhuesi siguron një fotografi të dizajnuar të çdo tipi të burimit të prodhuar dhe një fotografi të kontejnerit tipik të burimit.

3. Ndërmarrja siguron që çdo burim i mbyllur me aktivitetit të lartë shoqërohet me informacionin me shkrim që tregon se burimi është identifikuar dhe shënuar në përputhje me pikën 1 dhe se shenjat dhe etiketat e përmendura në pikën 1 mbeten të lexueshme. Informacioni duhet të përfshijë fotografitë e burimit, kontejnerin e burimit, paketimin e transportit, pajisjen dhe pajimet sipas rastit.

1.17. Aneksi XVII

Lista treguese e llojeve të situatave të ekspozimit ekzistues siç referohet në nenin 100 të Direktivës 2013/59/EUROATOM

1. Ekspozimi për shkak të kontaminimit të zonave nga materiali radioaktiv i mbetur nga:
 - 1.1. Aktivitetet që nuk kanë qenë kurrë subjekt i kontrollit rregullator ose nuk janë rregulluar në përputhje me kërkesat e përcaktuara ligjore;
 - 1.2. Në emergjencë, pasi situata e ekspozimit emergjent është shpallur e mbyllur, siç parashikohet në sistemin e menaxhimit emergjent;
 - 1.3. Mbetjet nga aktivitetet e kaluara për të cilat ndërmarrrja nuk është më ligjërisht përgjegjëse;
2. Ekspozimi ndaj burimeve natyrorë të rrezatimit, duke përfshirë:
 - 2.1. Ekspozimi ndaj radonit dhe toronit në hapësira të mbyllura, në vendet e punës, banesa dhe ndërtesa tjera;
 - 2.2. Ekspozimi brenda hapësirave të mbyllura nga materialet e ndërtimit;
3. Ekspozimi ndaj mallrave me përjashtim të ushqimit, ushqimeve të kafshëve dhe ujit të pijshëm që përfshin
 - 3.1. Radionuklide nga zonat e kontaminuara të specifikuara në pikën 1, ose
 - 3.2. Radionuklidët natyrorë.

1.18. Aneksi XVIII

Lista e artikujve që merren parasysh gjat përgatitjes së planit kombëtar të veprimit për zgjidhjen e rreziqeve afatgjata nga ekspozimet e radonit nga nenet 54, 74 dhe 103 të Direktivës 2013/59/EUROATOM

1. Strategjia për kryerjen e vrojtimeve të përqendrimit të radonit në hapësira të mbyllura ose të përqendrimit të gazrave tokësor me qëllim të vlerësimit të shpërndarjes së përqendrimit të radonit në hapësira të mbyllura, për menaxhimin e të dhënave të matjes dhe për vendosjen e parametrave të tjerë përkatës (si p.sh. llojet e tokës dhe shkëmbit, përshkueshmëria dhe përmbajtja e radiumi-226 në shkëmbinj ose tokë).
2. Qasja, të dhënat dhe kriteret e përdorura për përcaktimin e zonave ose për përcaktimin e parametrave të tjerë që mund të përdoren si tregues specifik të situatave me ekspozim potencialisht të lartë ndaj radonit.
3. Identifikimi i llojeve të vendeve të punës dhe ndërtesave me qasje nga publiku, siç janë shkollat, vendet nëntokësore të punës dhe ato në zona të caktuara ku kërkohen matje në bazë të një vlerësimi të rrezikut, duke marrë parasysh për shembull orët e mbajtura.
4. Baza për vendosjen e niveleve të referencës për banesat dhe vendet e punës. Nëse është e nevojshme, baza për vendosjen e niveleve të ndryshme të referencës për përdorime të ndryshme të ndërtesave (banesa, ndërtesa publike, vendet e punës), si dhe për ndërtesat ekzistuese dhe për ndërtesat e reja.
5. Caktimi i përgjegjësive (qeveritare dhe joqeveritare), mekanizmat e koordinimit dhe burimet në dispozicion për zbatimin e planit të veprimit.
6. Strategjia për zvogëlimin e ekspozimit të radonit në banesa dhe për dhënien e përparësisë në adresimin e situatave të identifikuara në pikën 2.
7. Strategjitë për lehtësimin e veprimit përmirësues pas ndërtimit.
8. Strategjia, duke përfshirë metodat dhe mjetet për parandalimin e hyrjes së radonit në ndërtesat e reja, duke përfshirë identifikimin e materialeve të ndërtimit me dalje të konsiderueshëm të radonit.
9. Planifikimet për shqyrtimin e planit të veprimit.
10. Strategjia për komunikim për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe për të informuar vendimmarrësit lokal, punëdhënësit dhe punonjësit për rreziqet e radonit, duke përfshirë edhe ato në lidhje me pirjen e duhanit.
11. Udhëzime për metodat dhe mjetet për matjet dhe masat përmirësuese. Gjithashtu, merren parasysh kriteret për akreditimin e shërbimeve të matjes dhe të rehabilitimit.
12. Kur është e mundur, ofrimi i mbështetjes financiare për vrojtimet e radonit dhe për masat përmirësuese, veçanërisht për banesat private me përqendrim shumë të larta të radonit.
13. Qëllimet afatgjata në drejtim të uljes së rrezikut të kancerit të mushkërive që i atribuohet ekspozimit të radonit (për duhanpirësit dhe jo duhanpirësit).

14. Kur është e mundur, shqyrtimi i çështjeve të tjera të ndërlidhura dhe programet përkatëse siç janë programet për kursimin e energjisë dhe cilësinë e ajrit të brendshëm.

1.19. Aneksi XIX

Praktikat e rrezatimit që i nënshtrohen vetëm regjistrimit

No.	Emërtimi i Praktikës	Përshkrimi
1	Fluoreshenca me rreze X	Përdorimi i pajisjeve që emetojnë rreze X në aparatura rrezatimi për qëllime analize.
2	Dedektimi me kapje elektronike	Përdorimi i burimeve të mbyllura në gaz kromatografi; nëse pajisja përmban më pak se 10 x EQ (p.sh., për Ni-63 kjo do të thotë më pak se 1 GBq) përjashtohet nga licencimi. Gjithashtu përdoret edhe H-3.
3	Analiza e mineraleve të kockave	Përdorimi i një aparature rrezatimi për të analizuar kockat tek njeriu.
4	Matësit (sondat) me shpërhapje beta në kah të kundërt	Përdorimi i një burimi radioaktiv beta emetues i bashkangjitur në pajisjet e rrezatimit për të matur trashësinë e materialeve dhe shtresave veshëse.
5	Testimi i komponenteve elektronike	Përdorimi i Kr-85 për të testuar integritetin e komponenteve elektronike.
6	Kërkim – burime radioaktive të mbyllura me aktivitet maksimal prej 50 MBq	Përdorimi i burimeve të mbyllura për qëllime kërkimore. Aktiviteti maksimal për secilin burim të mbyllur është më pak se 50 MBq.
7	Industri - burime radioaktive të mbyllura me aktivitet maksimal prej 100 MBq	Aplikacionet industriale të aparaturave të rrezatimit dhe burimeve të mbyllura që nuk mbulojnë nga përdorime-lloje të tjera. Përdorimet mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, matësit (sondat) e karburantit në aeroplan, përbërësit e avionëve dhe ndezësit me shkarkesë.
8	Dedektimi i pikës së vesës	Përdorimi i burimeve radioaktive të mbyllura në treguesit e vesës.
9	Eliminimi i ngarkesës statike	Zotërimi dhe përdorimi i aparaturave të rrezatimit që përmbajnë burime të mbyllura për eliminimin e ngarkesës statike.
10	Dedektimi i ngarkesës statike	Zotërimi dhe përdorimi i aparaturave të rrezatimit për dedektimin e ngarkesës statike.
11	Radio-lumineshenca	Përdorimi i aparaturave të rrezatimit me vetë-ndriçim, të aktivuara me tritium.
12	Mbrojtja nga goditjet e tensionit	Përdorimi i aparaturave të rrezatimit për të kufizuar goditjet e tensionit në komponentet elektronike.
13	Komponime radioactive me ndriçim	Zotërimi i instrumenteve që përmbajnë burime radioaktive me ndriçim për ekran ose përdorim.
14	Inspektimi në distancë i helikave	Përdorimi i aparaturave të rrezatimit për të monitoruar integritetin e helikës së helikopterit.
15	Mësimdhënie – burime radioaktive të mbyllura me aktivitet maksimal deri në 50 MBq	Përdorimi i burimeve të mbyllura për qëllime të mësimdhënies.
16	Burime radioaktive kontrolli	Zotërimi i burimeve të mbyllura të vogla me qëllim kontrollimin e funksionimit të instrumenteve të dedektimit të radioaktivitetit, kur burimet e kontrollit nuk përjashtohen sipas seksionit 8.1 të NSRD.
17	Numërues me shintilator të lëngët	Shumë prej tyre tani përjashtohen sipas NSRD, numëruesit me shintilator të lëngët shpesh gjenden në laboratorë dhe shoqërohen me 815 dhe operacione të tjera ose të pavarura në situata laboratorike për matjen e emetuesve beta me aktivitet të ulët.
18	Vendet e punës	Vendet e punës që tejkalojnë vlerat e referencës për radonin dhe për situatat ekzistuese të ekspozimit të cilat janë shqetësuese nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi.

19	Praktika që përfshin materiale radioaktive me origjinë natyrore	Ekspozimi i punëtorëve apo anëtarëve të publikut që nuk mund të shpërfillen nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi, përfshirë sektorët industrial.
----	---	---